




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Municipality Drenas
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 060-44060 dt. 30/07/2018

Për: Ministrinë e Administimit të Pushtetit Lokal, Prishtinë

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci




Lënda: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt. 26/07/2018

1. Vendim për ridestininim të mjeteve në Drejtoratin e Shërbimeve Publike.
2. Vendim për formimin e komisionit të ankesave, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim.
3. Vendim për ridestininimin e mjeteve nga Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Vendimi për Memorandum Mirëkuptimi.
5. Rregullore për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në Komunën e Drenasit.
6. Vendimin, për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrale, në zonën kadastrale në Verboc.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. _____ dt. _____ 2018

Nga; Kryesuesi I Kuvendit Komunës z.Labinot Halilaj

Për; Krytarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi I Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.07.2018




1. Vendimi për ridestitimine mjetëve në Drejtoratin e Sherbimeve Publike
2. Vendim për formimin e komisionit të ankesave për dhenjen e pronës së palujtëshme komunale në shfytëzim.
3. Vendim për ridestitimimin e mjetëve nga Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Vendimi për Memorandum Mirkuptimi.
5. Rregullorja për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në Komunen e Drenasit.
6. Vendim për shpalljen e interest të përgjithshem Publik të ngastrës kadastrale në zonën kadastrale në Vërbovc.

Drenas,

27.07.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 12-400-43975 dt. 30/07/ 2018



Në bazë të nenit 11, 12 pika d), dhe nenit 40 pika j) të ligjit nr. 30/L për Vëtqeverisjen Lokale, neni 34 oika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullte me date 26.07.2018 miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim aprovohet Memorandum Mirkuptimi që pasuria natyrore e Bjeshkëve të Qyqavicës, e cila shtrihet në terriorin e pesë (5) komunave të shpallët zonë me interes të pergjithëshem.

Neni 2

Pjesë e nënshkrimit të këtij memorandumi të cekur në nenin 1, të këtij vendimi jonë pesë (5) Komunat si:

1. Komuna e Mitrovicës
2. Komuna e Skenderajit
3. Komuna e Drenasit
4. Komuna e Vushtrrisë dhe
5. Komuna e Obiliqit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmërise nga MAPL-ja dhe 7dite pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Rabinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 12-341-43981 dt. 30/04/2018



Duke u bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetqeverisje lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3 si dhe nenit 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji Nr.03/L-139), dhe vendimit të Këshillit Kombëtar për Investime në nivel të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.07.2018 miraton këtë:

V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të ngastrave kadastrale në zonën kadastrale në Verboc sipas studimit të fizibilitetit për parcelat që i përfshinë akumulacioni

I. APROVOHET vendimi për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik për ngastrat kadastrale si: ngastrat kadastrale zona kadastrale në fshatin Verboc për ndërtimin e PENDËS për grumbullimin e ujit – Liqenit akumulues.

II. SHPALLET Interes i Përgjithshëm Publik kjo paluajtshmëri e cila gjendet në fshatin Verboc të lagja Rrukiqi, gjegjësisht në zonën kadastrale Verboc Komuna e Drenasit – Gllogocit .

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e mëtejme për shpronësim të ngastrave kadastrale në vendin ku behët ndërtimi i Pendës dhe rezervuarit-grumbullues të ujit (liqenit artificial), sepse shpronësimi i atyre pronave (ngastrave kadastrale) bëhet nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministria e Financave .

IV. Me kwtw vndimi pas përfundimit të procedurës së shpronësimit obligohet Drejtatori për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë bartjen administrative të pronës së shpronësuar.

V. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe 7dite pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labir Hot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. 12-462-43997 dt 30/07/2018

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 të Rregullores Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 26.07.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit të Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni i Ankesave i cili do të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Komision e përbejnë një (1) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, një (1) anëtar nga Kuvendi i Komunës dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës, si vijon:

1. Armend Hajdini anëtar nga ekzekutivi
2. Adem Bucollii anëtar nga kuvendi
3. Alban Bujupi përfaqësues (ekspert) nga shoqëria civile, Anëtar,;

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit të Ankesave është që të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim duke u bazuar në nenin 3 të Rregullores Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pala e pa kënaqur nga procesi i vlerësimit final të ofertave nga Komisioni për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, ka të drejtë të paraqes ankesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve në Komisionin e Ankesave, i cili shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Neni 4

Ky komision bënë shqyrtimin e ankesave brenda 30 ditëve, nga dita e pranimit të Ankesës nga pala në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Neni 5

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në përfundim të mandatit të anëtarve të kuvendit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.




Kryetari i Kuvendit të Komunës

Halil Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 12-400-44004 dt. 30/07/2018



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 26.07. 2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet ridestinimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtorati për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 2 .

Ridestinimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale me këto shuma :

- 1.Kanalizimi i Ujrave të zeza në Likoshan më kod të projektit **89086 (10)** në shumë prej:5,517.00 €
- 2.Kanalizimi i ujrave të zeza në Fshatin Gllanasell më kod të projektit **46119 (10)** në shumë prej: 1,040.00 €
- 3.Asfaltimi i rrugës Gllanasellë më kod të projektit **40028 (10)** në shumë prej:5,687.50 €
- 4.Asfaltimi i rrugës në fshatin Likoshan më kod të projektit (89085) në shumë prej:3,737.65 €
- 5.Asfaltimi i Rrugës Gradicë me kod të projektit **46101 (10)** dhe shumë prej: 2,960.95 €
- 6.Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Shtutic më kod të projektit **89089 (21)** në shumë prej:8,933.00 €

Ridestinimi në shumë prej : 27,876.10 €

Neni 3.

Ridestinimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestinohen në këto projektet kapitale:

1. Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Gradicë më kod projekti **89077 (10)** dhe në shumë prej : 6,557.00 €
- 3.Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec me kod të projektit **44745 (10)** në shumë prej: 12,386.10 €
2. Kanalizimi i ujrave të zeza Verbovc me kod projekti **89089 (21)** në shumë prej:8,933.00 €

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe 7dite pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Halil Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNES

Nr. 12-400-44011 dt 30/07/ 2018



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40, paragrafi 2.Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 26.07.2018 miratoj këtë:

VENDIM
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE PËR SHPENZIME KAPTALE

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet ridestinimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor të Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 2

Ridestinimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale më këto në shuma:

- Kodi i projektit I : 10/611/18001/00000/0451, Trajtimi i qenve endacak ... 10,000.00 €
- Kodi i projektit II : 10/611/18001/31270/46403/0451, Rregullimi i vendndaljeve dhe mbulimi i tyre 5,414.80 €,
- Kodi i projektit III : 10/611/18001/18001/31240/460038/0451, rregullimi i parkingjeve 1,526.50€

Vlera totale nga këto projekte është 16,941.30 €

Neni 3

Shuma e mjeteve për ridestinim e përmendur në neni 2 i këtij Vendimi do të shpenzohen në këtë kategori ekonomike të shpenzimeve, konkretisht në këtë projekt

I. ShpenzimetKapitale:

- Drejtorati për Shërbime Publike dhe emergjencë ridestinimin e mjeteve e mjeteve do t'i shpenzoj në këtë projekt kapital :

- Kodi i projektit :10/611/18001/31270/46034/0451 , Rregullimi i tregut të gjelbert.....16,941.30 €

Gjithsejt investimet kapitale në shumë prej: 16,941.30 €

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe 7dite pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



Nr 12-030-4404/dt 30/07/ 2018

RREGULLORE PËR MBROJTJEN DHE REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE NË KOMUNËN E DRENASIT

Drenas, Korrik 2018

Nw bazw tw nenit 11, 12 paragrafi 12.2 shkronja c dhe nenit 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt me datën: 26/07/ të vitit 2018 aprovoj këtë:

**RREGULLORE PËR MBROJTJEN DHE REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE NË KOMUNËN E DRENASIT
(PËR NJË KOMUNË MIKE PËR FËMIJË)**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton masat për realizimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e qeverisjes komunale dhe kontribon në krijimin e një ambienti më të sigurtë dhe më të përshtatshëm për fëmijë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët (veçanërisht për fëmijët më të përjashtuar dhe më të cenuar) pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, orientimi seksual, mendimi politik apo ndonjë mendimi tjetër, origjine kombëtare, përkatësie etnike, statusi social, aftësie të kufizuar, prejardhje familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor, dhe shtrihet në të gjitha institucionet të cilat janë nën administrimin e komunës së Drenasit apo veprojnë në nivel komunal (organizata të ndryshme jo-qeveritare), përderisa pavarësia e tyre nuk çënohet në përputhje me ligjin.
3. Kjo rregullore është kontribut për të siguruar se Drenasi hap pas hapi po ndërton një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Neni 2

Përkufizimi i fëmijës

1. Fëmijë konsiderohet çdo person nën moshën 18 vjeçare.
2. Fëmijët i gëzojnë të gjitha të drejtat e njeriut siç parashihen në Konventën e KB-së për të Drejtat e Fëmijës, dhe në Ligjet, Konventat dhe Standardet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës që sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të tyre.
3. Fëmijët janë një kategori e veçantë e personave të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik dhe intelektual, dhe pjekurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet qeveritare mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore deri në moshën 18 vjeçare.

Neni 3

Parimet e përgjithshme të të drejtave të fëmijës

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejta të fëmijës në mënyrë të plotë siç janë përcaktuar në konventë.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni përkatës që rregullon fushën e mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të fëmijëve udhëhiqen nga parimet e Konventës:
 - a. **Mosdiskriminimi** - që nënkupton se të gjithë fëmijët brenda juridiksionit lokal i gëzojnë të drejtat e barabarta pavarësisht dallimeve të sqaruara në Nenin 1, pika 2 të kësaj rregulloreje.
 - b. **Interesat më të mira të fëmijës** - që nënkupton se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës i cili është subjekt i vendimit.
 - c. **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit** - që nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, edukativo-arsimor, shëndetësor, social, sportiv dhe kulturor.
 - d. **Pikëpamjet e fëmijës** - që nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta përkitazi me ligjin, si dhe obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar këto pikëpamje dhe për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit mendor të fëmijës.
3. Parimet e Konventës zbatohen në mënyrë direkte në legjislacionin vendor.

Neni 4

Komuna mike për fëmijë

1. Komuna mike për fëmijët është një sistem i qeverisjes së mirë lokale, e angazhuar për zbatimin e plotë të Konventës dhe transformimin e Konventës në praktikë të përditshme.
2. Komuna mike për fëmijë i garanton secilit fëmijë që do:
 - a. Të jetë një qytetar i barabartë i komunës, me qasje në secilin shërbim të disponueshëm, pavarësisht dallimeve të sqaruara në Nenin 1, pika 2 të kësaj rregulloreje
 - b. Të ndikojë apo marrë pjesë në vendimet e komunës së vet, përkitazi me ligjin;
 - c. Të shprehë pikëpamjet për komunën që do;
 - d. Të marrë shërbimet kryesore si kujdesin shëndetësor, arsimimin dhe kujdesin alternativ;
 - e. Të marrë pjesë në jetën familjare, të komunitetit dhe atë sociale;
 - f. Të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna, abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër;

- g. Të ketë qasje në ambient të pastër dhe të shëndetshëm;
- h. T'i mundësohet lëvizje e lirë dhe e sigurt;
- i. T'i sigurohet përfshirje e barabartë sociale, sportive dhe kulturore;

DISPOZITA SPECIFIKE

Neni 5

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijëve

Mbrojtja dhe realizimi i të drejtave të fëmijëve është përgjegjësi kryesore e familjes dhe llogaridhënie ligjore dhe e vetë-imponuar e institucioneve qeveritare.

Çdo zyrtar publik, secili institucion komunal, çdo institucion në nivel qendror që vepron në nivel komunal dhe çdo subjekt tjetër që lidhet me fëmijët – të gjithë kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me konceptin e komunës mike për fëmijë.

Lista e palëve përgjegjëse për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijës në komunë përfshin (por nuk kufizohet në) këto palë:

- a. Zyra e Kryetarit të Komunës, kuvendi dhe drejtoritë komunale;
- b. Ministritë e linjës me kompetenca të deleguara ose të zgjeruara;
- c. Organet e drejtësisë për fëmijë (policia, gjykata, prokuroria);
- d. Mekanizmi koordinues për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komunal;
- e. Zyra për të drejtat e njeriut, mbrojtje nga diskriminimi, dhe barazi gjinore në komunë;
- f. Qendra për punë sociale;
- g. Institucionet shëndetësore;
- h. Shkollat, çerdhet, dhe institucionet parashkollore publike dhe private të arsimit;
- i. Klubet dhe shoqatat sportive dhe artistike;
- j. Institucioni i avokatit të popullit (Ombudspersonit);
- k. Shërbimi sprovues;
- l. Bashkësitë lokale;
- m. Këshilli i prindërve;
- n. Organizatat e shoqërisë civile;
- o. Zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në komunë;
- p. Shoqatat profesionale;

- q. Organet tjera (formale dhe joformale) që si qëllim parësor kanë promovimin e mbrojtjes së përgjithshme sociale dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve;

Neni 6

Mekanizmi koordinues për të drejtat e fëmijës

1. Mekanizmi koordinues komunal shërben si një platformë apo rrugë për vendosjen e prioriteteve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për trajtimin e çështjeve dhe ofrimin e zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese.
2. Mekanizmi koordinues komunal krijon një mjedis mundësues për përgatitjen e planeve të veta për zhvillim, alokon buxhetet dhe monitoron zbatimin e programeve të tyre përkatëse.
3. Kryetari i Komunës kryeson mekanizmin koordinues (apo delegon dikë) dhe është përgjegjës për angazhimet e Kuvendit Komunal për politikën dhe shërbimet për fëmijë.
4. Komuna, me lëshimin e një vendimi të veçantë, themelon mekanizmin koordinues për realizimin e të drejtave të fëmijës në sistemin e qeverisjes komunale përfshirë kushtet e punës të përkufizuara për rolet, përgjegjësitë dhe procedurat.
5. Ky mekanizëm është i përbërë nga palë dhe institucione të ndryshme dhe në të përfaqësohen edhe njësi të ndryshme si dhe grupe të tjera formale dhe joformale. Përbërja e këtij mekanizmi përcaktohet nga akti i themelimit të mekanizmit me kushtet e punës të përkufizuara.
6. Mekanizmi duhet të:
 - a. Promovojë konceptin e komunës mike për fëmijë dhe praktikën e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;
 - b. Sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve;
 - c. Sigurojë që të gjitha aspektet e kornizës ligjore të cilat janë nën kontrollin e komunës i promovojnë dhe i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Ndërkohë, vepron si një mbështetës i fuqishëm i fëmijëve;
 - d. Kryejë vetëvlerësime periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga komuna në mënyrë që të ofrohet një politik-bënjë për krijimin e një komunë mike për fëmijë;
 - e. Udhëheqë procesin e hartimit të një strategjie komunale dhe një plani të veprimit për fëmijë, i cili rishikohet në baza vjetore, dhe vëzhgon zbatimin e tij bazuar në vetëvlerësimin komunal;

- f. Sigurojë komunikim dhe rrjedhje të informacionit përmes pikëpamjeve të fëmijëve që konfirmon se ata janë duke u respektuar në punën e mekanizmit dhe mbarë qeverisjes në nivel komunal;
 - g. Sigurojë në sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njësisve specifike të institucioneve relevante përgjegjëse për çështjet e fëmijëve;
 - h. Bëjë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
 - i. Strategjitë komunale dhe planet e veprimit për të drejtat e fëmijëve hyjnë në fuqi me vendim të Kryetarit të Komunës.
7. Mekanizmi nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe mekanizmave të tjerë, në vartësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, kjo e fundit duhet t'i mbajë marrëdhëniet me mekanizmin, të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmi koordinues.
8. Mekanizmit i ipet autoriteti më i lartë i komunës, që do të thotë se ai i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës.

Neni 7

Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit dhe programeve për fëmijë në jetën e tyre.
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve, me vëmendje të veçantë tek fëmijët nga grupet e cënueshme.
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët, gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve për të pasur ndikim në vendim-marrje.
4. Kryen një vlerësim të rregullt të ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët.
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikat dhe shërbimet për fëmijë.

Neni 8

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës i raporton Kuvendit Komunal për të siguruar funksionimin efektiv të mekanizmit të koordinimit dhe raportimin e rregullt për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Mekanizmi koordinues komunal i përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritet të komunës për fëmijët dhe interesat e tyre. Ky mekanizëm obligon komunën të raportojë në

mënyrë periodike mbi treguesit, dhe të asistojë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit për një komunë mike për fëmijë.

3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatës, të lidhura me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në rast kur komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror.
4. Komuna e cakton njësinë përgjegjëse në komunë për të nxjerrë të dhëna të rëndësishme dhe raportim të rregullt mbi statusin e treguesve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe u raportohet zyrtarisht në bazë periodike.
5. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetim për fëmijë dhe duke u bazuar në nevoja kërkon nga njësitë përgjegjëse t'i azhurojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë.
6. Bazuar në trendet e zhvillimit komunal dhe shtetëror, komuna i shqyrton treguesit dhe raporton periodikisht në mënyrë që t'i rishikojë ato bazuar në nevoja.

Neni 9

Buxheti për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:
 - a. Identifikimin nëse fëmijët e kësaj komune janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime ku shpërndarja administrohet nga niveli i vendit;
 - b. Analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë;
2. Komuna zhvillon një proces për planifikim të buxhetit komunal i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët, duke i përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.

Neni 10

Promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe bërja e çështjeve të fëmijëve më të dukshme

1. Komuna ndërmerr masa të qarta në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- a. Organizmin e trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit komunal dhe zyrtarët përgjegjës;
 - b. Përfshirjen e informimit rreth të drejtave të fëmijëve dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në të gjitha nivelet e edukimit;
 - c. Përfshirjen e mësimi dhe promovimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit, për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë.
 - d. Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve;
 - e. Promovimin e punës së institucioneve të cilat e kanë për mandat ligjor promovimin, monitorimin, dhe sensibilizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
3. Komuna krijon partneritete me institucionet qendrore dhe gjithashtu me organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve.

Neni 11

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon një sistem të qëndrueshëm të partneritetit me një spektër të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve. Në këtë drejtim:
 - a. Organizatave joqeveritare u ipet mbështetje adekuate për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje në mënyrë të pavarur, në fushën e të drejtave të fëmijëve;
 - b. Inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjve dhe fëmijëve;
 - c. Lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve;
 - d. Mbahen komunikime të rregullta me OJQ-të dhe institucionet e pavarura në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë në raport me situatën e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Kuvendi komunal organizon të paktën një seancë vjetore për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijës duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë (Neni 8, pika 4 e kësaj rregulloreje);
3. Komuna organizon "ditët mike për fëmijë" (të paktën 3 ditë në vit), dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijës.

Neni 12

Cilësia e shërbimeve për fëmijët në nevojë

1. Komuna ndërmerr masa për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët në nevojë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Komuna bashkëpunon ngushtë dhe bën kontraktimin e shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Pjesëmarrja e fëmijës

1. Komuna siguron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në rastet me interes për ta në çdo proces vendim-marrës në nivel komune. Të gjithë zyrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale institucionale relevante janë të obliguara ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre;
2. Institucionet edukative e mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës të cilët janë drejtpërdrejt në kontakt me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve për ta (shëndetësia, mirëqenia sociale, drejtësia);
3. Institucionet edukative, sportive dhe kulturore e nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjëve, klubeve sportive, artistike dhe kulturore;
4. Organet administrative dhe gjyqësore në kuadër të komunës në rastin e vendim-marrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve, dhe në përputhje me praktikën dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues dhe i përshtatshëm për moshën e tyre;
5. Pjesëmarrja kuptimplotë e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët, në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë, në procesin e buxhetimit për fëmijë si dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve për fëmijë dhe të rritur;
6. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, komuna e merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me Asamblenë Komunale të Fëmijëve si organ primar që i përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve, në veçanti të atyre më të cënuarve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Mekanizmi i koordinimit (ose ndonjë organ tjetër komunal, ose i pavarur) e monitoron zbatimin e rregullores dhe prodhon raporte periodike.
2. Kuvendi Komunal i rishikon dhe i miraton raportet dhe bazuar në këtë miratim merr vendime për masat eventuale për sigurimin e zbatimit të tij të plotë.
3. Në rast të shkeljes së detyrave lidhur me zbatimin e Rregullores nga zyrtarë publikë, organet përkatëse komunale marrin masa adekuate në pajtim me procedurat komunale.
4. Përgjegjësitë komunale të përcaktuara në Nenin 6, pikën 1 dhe 6, paragrafi f.; Nenin 8, pikën 3 do të bëhen zyrtare me vendim zyrtar të marrë nga Kryetari i Komunës dhe merren më së voni 3-6 muaj pasi rregullorja të hyjë në fuqi.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlersimit të ligjshmërise nga MAPL-ja dhe 7dite pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

